



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.09.2022

**MBLEDHJA Nr. 40,**  
**Datë 22.09.2022, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 22.09.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 40 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 12.09.2022
2. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Smart Trade and Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Bindi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017
4. Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit
5. Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.
7. Mbi një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 21.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 vjeçar”
8. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**